

E DREJTA NË INFORMIM E KOMUNITETEVE JO SHUMICË

**“Komuna e Prizrenit
dhe e Dragashit”**



E DREJTA NË INFORMIM E KOMUNITETEVE JO SHUMICË

**“Komuna e Prizrenit
dhe e Dragashit”**



TIC INSTITUTE (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat e rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdorë citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45

10000, Prishtinë, Kosovë.

Tel.: +383 (0)38 248 038

E-mail: info@kdi-kosova.org

Web: www.kdi-kosova.org

Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me përkrahjen e Olof Palme International Center. Opinionet, të gjeturat dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e KDI-së dhe jodomsdoshmërisht paraqesin qëndrimet e donatorit.

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE	6
METODOLOGJIA.....	7
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	8
KORNIZA LIGJORE	10
RESPEKTIMI I LIGJIT PËR PËRDORIMIN E GJUHËVE.....	13
Komuna e Prizrenit	14
Kryetari i Komunës	17
Kuvendi i Komunës	18
Qasje në dokumente publike dhe konsultimet publike	19
Komuna e Dragashit.....	20
Kryetari i Komunës	23
Kuvendi i Komunës	24
Qasje në dokumente publike dhe konsultimet publike	25
REKOMANDIMET	26
LISTA E BURIMEVE TË SHFRYTËZUARA	27



HYRJE

Informimi i komuniteteve jo shumicë në kohë, ofrimi i mundësisë për pjesëmarrjen e tyre në proceset e hartimit dhe zbatimit të politikave në nivel lokal, përveç që është obligim ligjor është edhe indikator për një qeverisje që i njeh ata si të barabartë dhe respekton vlerat dhe të drejtat e tyre. Diskriminim pozitiv i komuniteteve jo-shumicë në këto procese është vlerë e shtuar në aspektin e formimit të qeverisjes e cila synon zbatimin e vlerave demokratike.

Raporti "E drejta në Informim të Komuniteteve jo-shumicë" jep një pasqyrë të qartë në zbatimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve dhe legjislacionit sekondar që rregullon dhe garanton këtë të drejtë, nga dy institucione lokale, komuna e Prizrenit dhe ajo e Dragashit. Ky raport njëkohësisht paraqet sfidat dhe gjendjen e tashme të respektimit të së drejtës për informim të komuniteteve jo shumicë në dy institucionet lokale të targetuara.

Gjetjet dhe të dhënat në këtë raport janë gjeneruar nga monitorimi i ueb faqeve zyrtare të të dy komunave, nga kërkesat për qasje në dokumente publike në gjuhët zyrtare në nivel lokal si dhe nga monitorimi i konsultimeve publike në aspektin e ofrimit të mundësive për pjesëmarrje të komuniteteve jo-shumicë në këto procese. Monitorimi përfshin periudhën Janar – Qershor 2019. Publikimi i vendimeve të ekzekutivit, vendimet e Kuvendit të Komunës, komunikimi i institucioneve përmes rrjeteve sociale me qytetarë si dhe publikimi i dokumenteve të tjera të rëndësishme për pjesëmarrjen e komuniteteve jo-shumicë në proceset vendimmarrëse janë shtyllat kryesore të këtij raporti.





METODOLOGJIA

Gjatë procesit të hartimit të këtij hulumtimi është zbatuar metodologjia e monitorimit të vazhdueshëm të ueb faqeve zyrtare të komunës së Prizrenit dhe komunës së Dragashit, në vazhden e zbatimit të legjislacionit primar dhe sekondar për respektimin e gjuhëve zyrtare në nivel lokal. Zyra e Kryetarit dhe Kuvendi i Komunës mbesin organe të qeverisjes lokale, të cilave u është kushtuar fokus i veçantë gjatë procesit të monitorimit të ueb faqeve zyrtare të komunave.

Si metodë hulumtuese janë përdorur edhe kërkesat për qasje në dokumentet publike në këto komuna, me qëllim të marrjes, analizimit dhe krahasimit të implementimit të legjislacionit primar dhe sekondar në respektimin e gjuhëve zyrtare në nivel lokal.

Monitorimi i konsultimeve publike në këto komuna në aspektin e respektimit të legjislacionit për gjuhët zyrtare ka qenë edhe një metodë shtesë për analizën hulumtuese. Janë vlerësuar të dhënat e ndryshme nga ueb faqet zyrtare për nxjerrjen e statistikave mbi publikimin e vendimeve, rregulloreve dhe akteve të tjera në gjuhët e tjera zyrtare në këto komuna. Vendimet, rregulloret dhe lajmet e komunës së Prizrenit dhe Dragashit kanë qenë pjesë e monitorimit të institucioneve në kontekst të qasjes së institucioneve në respektimin e legjislacionit për përdorimit të gjuhëve zyrtare.



Si metodë hulumtuese janë përdorur edhe kërkesat për qasje në dokumentet publike në këto komuna, me qëllim të marrjes, analizimit dhe krahasimit të implementimit të legjislacionit primar dhe sekondar në respektimin e gjuhëve zyrtare në nivel lokal.





përkthim adekuat në gjuhët zyrtare sa i përket draft dokumenteve dhe politikave publike në nivel lokal, të sigurojnë përkthim në takimet dhe konsultimet publike që organizojnë institucionet e dy komunave duke përfshirë edhe publikimin e ftesave dhe draft dokumenteve në të gjitha gjuhët zyrtare lokale. Po ashtu, komunikimet e institucioneve lokale në rrjetet sociale duhet të respektojnë parimin e gjuhëve zyrtare në nivel lokal të garantuara me legjislacion.

Me qëllim të zbatimit të plotë të legjislacionit në fuqi në përdorimin e gjuhëve zyrtare është themeluar Zyra e Komisionerit për Gjuhët e cila vepron në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Kjo Zyre mbikëqyrë zbatimin e Ligjit, me qëllim të ruajtjes, promovimit dhe mbrojtjes së përdorimit të gjuhëve zyrtare në Republikën e Kosovës; gjuhëve zyrtare të komunave; gjuhëve në përdorim zyrtarë në komuna; gjuhëve të komuniteteve gjuha amtare e të cilave nuk është njëra prej gjuhëve zyrtare.

Ngecjet e komunës së Prizrenit dhe Dragashit në respektimin e së drejtës për informim të komuniteteve jo shumicë duhet të aktivizojnë mekanizmat mbikqyrës kësisoj, Zyra e Komisionerit duhet të bëjë presion mbi institucionet lokale përkatësisht në komunën e Prizrenit të Dragashit me qëllim të respektimit të plotë të gjuhëve zyrtare në nivel lokal si dhe të filloj shqiptimin e sanksioneve administrative.

Komuna e Prizrenit dhe ajo e Dragashit duhet të angazhohen në rritjen e kapaciteteve institucionale në përkthimin e të gjitha dokumenteve duke përfshirë njoftimet, vendimet, raportet dhe gjithë dokumentacionin tjetër në gjuhët zyrtare në nivel lokal.





KORNIZA LIGJORE

E drejta për përdorimin e gjuhës amtare në komunikim me institucionet lokale rregullohet dhe garantohet me: Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre në Republikën e Kosovës, Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve, Ligji për Qasje në Dokumente Publike, Statutet e Komunave Prizren dhe Dragash, Rregulloret për Përdorimin e Gjuhëve në komunat Prizren dhe Dragash, Udhëzimin Administrativ Nr.04/2018 për Transparencë në Komuna, Rregulloren Nr.07/2012 për Zyrën e Komisionerit për Gjuhët dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 2007/01 për Përcaktimin e Sanksioneve Administrative për Shkeljen e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve.

Sipas parimeve të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës. Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe pjesëtarëve të komuniteteve.¹

Secili person në Kosovë gëzon të drejtën për qasje në dokumente publike/zyrtare. Dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, me përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatësisë, të sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë.²

Pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtë të përdorin gjuhën dhe alfabetin e tyre në marrëdhëniet e tyre me autoritetet komunale ose me zyret lokale të autoriteteve qendrore në fushat në të cilat ata përfaqësojnë një pjesë të mjaftueshme të popullatës, në pajtim me ligjin.³

Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, vetëqeverisja lokale bazohet në parimet e qeverisjes së mirë, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit në ofrimin e shërbimeve publike, duke u kushtuar kujdes të veçantë nevojave dhe brengave specifike të komuniteteve që nuk janë shumicë dhe pjesëtarëve të tyre.⁴

Ligji për Vetëqeverisje Lokale në Kosovë, obligon që të gjitha organet e komunës të kujdesen që qytetarët e komunës t'i gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë pa dallim race, etnie, ngjyre, gjinie, gjuhe, religjioni, mendimi politik apo mendimi tjetër, prejardhjeje kombëtare apo sociale, pa dallim prone, lindje apo ndonjë statusi tjetër me qëllim që ata të gëzojnë të drejta dhe mundësi të barabarta në shërbimet komunale të të gjitha niveleve.⁵

Përdorimi i gjuhëve në komunë rregullohet në pajtim me ligjin në fuqi për përdorimin e gjuhëve.⁶ Të gjithë personat kanë të drejta të barabarta në lidhje me përdorimin e gjuhëve zyrtare në institucionet Kosovës.⁷ Në komunat e banuara nga një bashkësi, gjuha amtare e të cilës nuk është gjuhë zyrtare dhe e cila përbën së paku pesë (5) përqind të popullsisë së përgjithshme

1 Neni 21 paragrafi 1 dhe 2, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, <http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Kushtetuta.e.Republikes.se.Kosoves.pdf>

2 Neni 41 i Kushtetutes se Republikës se Kosovës, <http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Kushtetuta.e.Republikes.se.Kosoves.pdf>

3 Neni 59 paragrafi 6, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, <http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Kushtetuta.e.Republikes.se.Kosoves.pdf>

4 Neni 123, paragrafi 4, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, <http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Kushtetuta.e.Republikes.se.Kosoves.pdf>

5 Neni 4, paragrafi 4.2, Ligji nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>

6 Neni 9, paragrafi 9.1, Ligji nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>

7 Neni 2, paragrafi 2, Ligji Nr. 02/L-37 për përdorimin e gjuhëve, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2440>



të asaj komune, gjuha e asaj bashkësie do të ketë statusin e gjuhës zyrtare në atë komunë dhe do përdoret barabartë me gjuhët zyrtare. Pavarësisht kësaj që u tha më lartë, në mënyrë të veçantë, në komunën e Prizrenit gjuha Turke do të ketë statusin e gjuhës zyrtare.⁸

Ligji përcakton se në ato komuna ku jeton një bashkësi, gjuha amtare e së cilës nuk është njëra nga gjuhët zyrtare në Kosovë dhe e cila përfaqëson më shumë se tre (3) përqind të popullatës së përgjithshme të komunës, gjuha e asaj bashkësie do të ketë statusin e gjuhës në përdorim zyrtar në atë komunë dhe do të jetë në përdorim të barabartë në pajtim me dispozitat e përcaktuara në këtij ligji. Përveç kësaj, një bashkësi, gjuha e së cilës me traditë është folur në një komunë, do të ketë statusin e gjuhës në përdorim zyrtar në atë komunë. Lidhur me këtë çështje, komunitat do të miratojnë rregullore të hollësisht brenda 6 muajve pas hyrjes së këtij ligji në fuqi.⁹

Çdo person ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë për të pranuar, kërkuar dhe për të dhënë informata dhe ide në gjuhën e zgjedhur, pa ndërhyrje. Pranimi i lirë i transmetimit tej kufitar, qoftë i drejtpërdrejtë apo nëpërmjet të ritransmetimit apo ri-emetimit nuk ndalohej në baza të gjuhës.¹⁰

Në institucionet komunale zbatohet barazia e gjuhëve zyrtare të komunës.¹¹ Shënimet e takimeve dhe shënimet zyrtare të organeve përfaqësuese dhe ekzekutive komunale, regjistrat publik dhe dokumente të tjera zyrtare, mbahen dhe lëshohen në të gjitha gjuhët zyrtare të komunës.¹²

Sipas Ligjit për përdorimin e gjuhëve institucionet komunale duhet të sigurojnë që mjedisi i tyre i punës të kontribuojë në përdorimin efektiv të gjuhëve zyrtare si dhe të mundësojë përdorimin e cilësdo gjuhë zyrtare nga zyrtarët dhe punëtorët e tyre. Rregulloret dhe aktet plotësuese të miratuara nga institucionet komunale nxirren dhe publikohen në gjuhët zyrtare të komunës. Versionet në gjuhët zyrtare janë të barasvlershme.¹³

Në territorin e komunës, gjuhë zyrtare janë: gjuha shqipe, gjuha serbe, gjuha boshnjake dhe gjuha turke. Pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtë të komunikojnë në gjuhën e tyre me organet dhe shërbimet civile në komunë, në pajtim me ligjet dhe me konventat ndërkombëtare në fuqi. Të gjitha dokumentet zyrtare të komunës, shtypen në gjuhët: shqipe, serbe, boshnjake dhe turke; të gjitha dokumentet zyrtare të lëshuara nga komuna me kërkesën e palës, do të jenë në pajtim me dispozitat e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve në Republikën e Kosovës. Gjuha e palës është ajo sipas së cilës pala me kërkesë u është drejtuar organeve të komunës.¹⁴

Rregullorja komunale në Prizren dhe Dragash thekson se gjuhët zyrtare përdoren në baza të barabarta në takimet me qytetarë, në punën e organeve të administratës, në kolegjiunin e drejtorëve, në komitetet e përhershme dhe në komitetet tjera, si dhe në mbledhjet e Kuvendit të Komunës.

Materialet për mbledhje, për anëtarët e Kuvendit dhe të komiteteve, komisioneve apo të trupave të tjera që themelohen nga Kuvendi, do të përgatiten dhe dërgohen në gjuhën për të cilën deklarohen vetë anëtarët.¹⁵

8 Neni 2 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 02/L-37 për përdorimin e gjuhëve, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2440>

9 Po aty neni paragrafi 4

10 Po aty neni 3 paragrafi 1

11 Po aty neni 7 paragrafi 1

12 Po aty neni 7 paragrafi 4

13 Po aty neni 7 paragrafi 5 dhe 6

14 Neni 11 dhe 12 i Statutit të Komunës së Prizrenit, [https://kk-arkiva.rks-gov.net/prizren/Kuvendi-\(1\)/Statut.aspx](https://kk-arkiva.rks-gov.net/prizren/Kuvendi-(1)/Statut.aspx)

15 Neni 3 i Rregullores për përdorimin e gjuhëve, komuna e Prizrenit, [https://kk-arkiva.rks-gov.net/prizren/getattachment/Kuvendi-\(1\)/Regulations/RregullorePërdoriminGjuheve.pdf.aspx?fbclid=IwAR2cD-mY9aFb62JBKyh0uMwjKPI817dKcYL_gocGQU57Sefx6DMvzR_ajl](https://kk-arkiva.rks-gov.net/prizren/getattachment/Kuvendi-(1)/Regulations/RregullorePërdoriminGjuheve.pdf.aspx?fbclid=IwAR2cD-mY9aFb62JBKyh0uMwjKPI817dKcYL_gocGQU57Sefx6DMvzR_ajl)

Personat që iu përkasin komuniteteve kanë të drejtë në lirinë e shprehjes, duke përfshirë të drejtën për të marrë dhe dhënë informacion dhe ide në gjuhën e komunitetit të tyre përkatës.¹⁶

Zyra e Komisionerit për Gjuhët themelohet në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.¹⁷ Zyra dhe Komisioneri për Gjuhët janë të pavarur në ushtrimin e funksioneve të tyre dhe operojnë në përputhje me parimet për paanshmëri, konfidentalitet dhe profesionalizëm dhe veprojnë në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin e Republikës së Kosovës.¹⁸ Zyra mbështetet nga dy mekanizma: Bordi për Politika të Gjuhëve dhe Rrjeti i Politikave për Gjuhët.¹⁹

Zyra mbikëqyrë zbatimin e Ligjit, me qëllim të ruajtjes, promovimit dhe mbrojtjes së: përdorimit të gjuhëve zyrtare në Republikën e Kosovës; gjuhëve zyrtare të komunave; gjuhëve në përdorim zyrtarë në komuna; gjuhëve të komuniteteve gjuha amtare e të cilave nuk është njëra prej gjuhëve zyrtare.²⁰ Juridiksioni i Zyrës mbulon përdorimin e gjuhëve nga institucionet e Republikës së Kosovës dhe organizatave dhe ndërmarrjeve tjera që kryejnë funksione dhe shërbime publike në territorin e Republikës së Kosovës.²¹

Përmes ankesave, hetimeve dhe funksionit të ndërmjetësimit, Zyra e Komisionerit për Gjuhë do të promovojë mjetet dhe zgjidhjet ligjore në rast të shkeljeve të dokumentuara të të drejtave gjuhësore përmes zhvillimit të hetimeve të pavarura; shqyrtimit, ndërmjetësimit dhe hetimit të ankesave që kanë të bëjnë me zbatimin e Ligjit; formulimit të rekomandimeve për mjetet ligjore dhe rekomandimet për

përmirësimin apo kompensimin; dhe si masë të fundit, përmes identifikimit dhe përcaktimit të sanksioneve me qëllim të zbatimit të përputhshmërisë nga institucionet përkatëse.²²

Sanksionet administrative kundër subjekteve të cilat bëjnë shkeljen e dispozitave të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve i shqipton Komisioni i Gjuhëve i paraparë në nenin 32 të Ligjit për Përdorim të Gjuhëve.²³

Personi i institucionit, i ndërmarrjes dhe i organizatës që realizon funksione dhe shërbime publike, nëse pas vërejtjes me shkrim nga Komisioni për Gjuhë, nuk ndërmerr masat dhe veprimet e parapara, Komisioni mund t'i shqiptojë sanksionin në shumë prej 20 deri në 100 euro.²⁴

Personi përgjegjës i institucionit, i ndërmarrjes dhe i organizatës që realizon funksione dhe shërbime publike, nëse pas vërejtjes me shkrim nga Komisioni për Gjuhë, nuk ndërmerr masat dhe veprimet e parapara, Komisioni mund t'i shqiptojë sanksionin në shumë prej 50 deri në 300 euro.²⁵

Institucionit, ndërmarrjes apo organizatës që realizon funksione dhe shërbime publike, nëse pas vërejtjes me shkrim nuk mënjanon lëshimet ose nuk vepron në bazë të rekomandimeve të Komisionit për Gjuhë, mund t'i shqiptohet sanksioni në shumën prej 300 deri në 1000 euro.²⁶

16 Neni 4, paragrafi 4.3 i Ligjit NR. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2531>

17 Neni 3 paragrafi 1 i Rregullores NR. 07/2012 për Zyrën e Komisionerit për Gjuhët, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8364>

18 Po aty neni 3 paragrafi 3

19 Po aty neni 5 paragrafi 1

20 Po aty neni 16 paragrafi 1

21 Po aty neni 16 paragrafi 3

22 Po aty neni 21 paragrafi 1

23 Neni 2 i Udhëzimit Administrativ Nr.2007/01-MSHP për përcaktimin e sanksioneve administrative për shkeljen e Ligjit për Përdorim të Gjuhëve, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7473&fbclid=IwAR2zWjEP0AGyumPzS6s6B2Ng17nyBYt6dFmXAXAvf2SBC6LE7WTJPkZyhA>

24 Po aty neni 6

25 Po aty neni 7

26 Po aty neni 8



ZBATIMI I LEGJISLACIONIT PËR PËRDORIMIN E GJUHËVE

Ueb faqja e komunës së Prizrenit nuk ka version të veçantë në gjuhën boshnjake edhe pse me ligjet në fuqi dhe statutin e komunës është gjuhë zyrtare në këtë komunë, ku sipas regjistrimit të popullsisë, jetojnë rreth 10 % anëtarë të këtij komuniteti jo-shumicë. Në kuadër të ueb faqes, gjuha boshnjake është e përfshirë në linkun e gjuhës serbe.

Publikimet janë të rregullta vetëm në gjuhën shqipe, në shumicën e gjuhëve të tjera nuk ka publikime nga autoritetet komunale në pothuajse të gjitha fushat: lajmet, prokurimet publike, thirrjet, konkurse, thirrjet për mbledhjet e Kuvendit ose Komitetet e Kuvendit. Në seksionin e ueb faqes ku janë informatat rreth qytetit, sipërfaqja, pozita gjeografike, harta e qytetit, emrat e rrugëve, fshatrat përshkrimi është në dispozicion vetëm në gjuhën shqipe.

Në faqen zyrtare të komunës së Prizrenit në kategorinë e "Prokurimit Publik", shpalljet publikohen vetëm në gjuhën shqipe, gjë që e bën të pamundur që pjesëtarët e komuniteteve pakicë që përdorin gjuhë të tjera zyrtare në komunë të kenë informata rreth prokurimit në komunën e Prizrenit.

Në rubrikën "Shpallje" ku përfshihen aplikacionet, konkursset dhe njoftimet, gjatë periudhës Janar- Qershor 2019 janë publikuar 56 shpallje, prej të cilave 11 konkurse, 33 njoftime dhe 12 thirrje për propozime. Prej 59 shpalljeve në gjuhën shqipe vetëm 34 janë publikuar në gjuhën serbe, përkatësisht 25 konkurse, 5 njoftime, dhe 4 thirrje për propozim. Në gjuhën turke janë publikuar vetëm 30 shpallje, përkatësisht 24 konkurse, 3 njoftime dhe 3 thirrje për propozime. Ndërsa në gjuhën boshnjake nuk ka asnjë publikim. Numri jo i barabartë i shpalljeve në gjuhët zyrtare ua mohon qytetarëve të komuniteteve pakicë të drejtën për t'u informuar rreth konkurseve, njoftimeve apo thirrjeve për propozime në komunën e Prizrenit.

Shpalljet e publikuara deri në muajin Qershor 2019 në Prizren




Tabela 1. Shpalljet e publikuara në periudhën Janar-Qershor të vitit 2019 në ueb faqen zyrtare



Në rubrikën "Prokurimi" komuna publikon vetëm njoftimet në gjuhën shqipe. Deri në muajin Qershor të vitit 2019 janë publikuar: **209** dokumente **në gjuhën shqipe**, prej të cilave, zero **(0)** dokumente në **gjuhën serbe**, zero **(0)** dokumente **në gjuhën boshnjake** dhe zero **(0)** dokumente në **gjuhën turke**.

Komuna e Prizrenit ka faqen zyrtare të saj në rrjetin social Facebook, e cila ka disa mijë ndjekës (11.569),²⁹ duke publikuar të gjitha publikimet, shpalljet, konkurset dhe informacione të tjera, si dhe aktivitetet e komunës dhe zyrtarëve komunal.

Publikimet në faqen zyrtare të komunës në këtë rrjet social bëhen vetëm në gjuhën shqipe, edhe pse gjuhë zyrtare të komunës janë edhe gjuha serbe, boshnjake dhe turke.

Në seksionin "Lajme" në faqen zyrtare të komunës lajmet që publikohen në gjuhën shqipe janë pa përkthim në gjuhën boshnjake, turke dhe serbe. Lajmet e publikuara në gjuhën shqipe në periudhën Janar - Qershor 2019 janë **293**, prej të cilave: **tri (3)** në gjuhën serbe, **dy (2)** në gjuhën turke dhe **zero (0)** në gjuhën boshnjake.



TABELA 2. Lajmet e publikuara në periudhën Janar - Qershor të vitit 2019 në ueb faqen zyrtare

29 Faqja zyrtare e Komunës së Prizrenit në rrjetin social Facebook - <https://www.facebook.com/kkprizren/>





Kryetari i Komunës

Kryetari i Komunës sipas përgjegjësisë të tij kujdeset për zbatimin e dispozitave të Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale dhe dispozitave tjera ligjore që kanë të bëjnë me përgjegjësitë e komunave. Kryetari i Komunës së Prizrenit në ueb faqe ka të publikuar biografinë vetëm në gjuhën shqipe, pa përk-

thim në gjuhët e tjera zyrtare. Deri në muajin Qershor të vitit 2019 në ueb faqen zyrtare të komunës janë publikuar **185** vendime të Kryetari të Komunës në gjuhën shqipe. Prej tyre në gjuhën serbe: zero (0) vendime, në gjuhën turke zero (0) vendime dhe në gjuhën boshnjake zero (0) vendime.



Tabela 3. Vendimet e publikuara nga Kryetari i Komunës së Prizrenit në periudhën Janar – Qershor 2019





Kuvendi i Komunës

Kuvendi i Komunës së Prizrenit në periudhën Janar – Qershor 2019, në ueb faqen zyrtare ka publikuar 6 vendime të Kuvendit Komunal. Në faqen zyrtare të komunës mungojnë dokumentet: “Rregullorja për Transparencë”, “Rregullorja e Punës së Kuvendit dhe Komiteteve” në gjuhën serbe, boshnjake dhe turke. Sa i përket respektimit të gjuhëve zyrtare në publikimin e vendimeve nga Kuvendi i Komunës, nga gjashtë (6) vendimet e publikuara në gjuhën shqipe, të njëjtat janë publikuar edhe në gjuhën serbe dhe turke, derisa në gjuhën boshnjake nuk është publikuar asnjë vendim i Kuvendit të Komunës.

Në ueb faqen e komunës së Prizrenit në seksionin e Kuvendi të Komunës, publikohen ftesat për mbajtjen e mbledhjeve të rregullta dhe atyre të jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës si dhe mbledhjet e Komiteteve të Kuvendit. Njoftimet për mbajtjen e mbledhjeve të organit më të lartë vendimmarrës dhe

trupave të tij, respektojnë standardet e gjuhëve zyrtare në nivel lokal duke përjashtuar respektimin e gjuhës boshnjake. Derisa Komiteti për Politikë dhe Financa respekton këto standarde, Komiteti për Komunitete nuk informon qytetarët për mbajtjen e mbledhjeve të këtij mekanizmi në asnjë gjuhë.

Megjithatë, Kuvendi i Komunës nuk respekton standardet e legjislacionit për gjuhët zyrtare sa i përket Planit të Punës të Kuvendit për vitin 2019 dhe Rregulloreve të ndryshme, të cilat janë të publikuara vetëm në gjuhën shqipe.

Komunitetet jo-shumicë janë përjashtuar nga mundësia e qasjes në informata që përshkruajnë funksionimin e komunës, statutin e komunës dhe rregulloret komunale. Asnjëri nga këto dokumente nuk pasqyrohet në gjuhën turke dhe boshnjake përkundër faktit që këto gjuhë cilësohen si gjuhë zyrtare në komunën e Prizrenit.



Tabela 4. Vendimet e publikuara në periudhën Janar – Qershor të vitit 2019





Qasja në dokumente publike dhe konsultimet publike



Çdo person ka të drejtë të komunikojë dhe të pranojë shërbimet e mundshme dhe dokumentet publike nga institucionet komunale dhe nga zyrtarët në cilëndo gjuhë zyrtare. Çdo organ përfaqësues dhe ekzekutiv komunal ka për detyrë të sigurojë se çdo person mund të komunikojë dhe të pranojë shërbimet në dispozicion dhe dokumentet publike nga çdo institucion dhe organ komunal në cilën do gjuhë zyrtare.³⁰ Në të njëjtin ligj definohehet që edhe aktet dhe rregulloret tjera të komunave duhet të nxirren dhe publikohen edhe në gjuhët zyrtare të Komunes.

Në komunat, personat të cilët iu takojnë komuniteteve, gjuha e të cilëve është në përdorim zyrtar, kanë të drejtë të paraqesin të gjitha kërkesat dhe dokumentet në formë të shkruar apo gojore si dhe të pranojnë përgjigjet në gjuhën e tyre nga institucionet dhe nga zyrtarët komunal, nëse ata kërkojnë kështu.³¹

Në punën dhe në takimet e organeve përfaqësuese komunale dhe komiteteve të tyre, si dhe në takimet publike të organizuara nga komuna, anëtarët e të cilave iu takojnë komuniteteve, gjuha amtare e të cilave nuk është gjuhë zyrtare, kanë të drejtë të përdorin gjuhën e tyre në punë dhe në takimet e organeve përfaqësuese të komunës, dhe komiteteve të tyre si dhe në takimet publike të organizuara nga komuna. Mjetet duhet të sigurohen për të mundësuar përkthimin nga dhe në gjuhën e anëtarit,

nëse kërkohet një shërbim i tillë. Çdo dokument i dorëzuar nga anëtarit i tillë përkthehet në gjuhët zyrtare dhe të gjitha përgjigjet e kërkuara do të kthehen në gjuhën e përdorur nga ana e tij.³²

Komuna e Prizrenit ka treguar një shkallë të ulët në respektimin e së drejtës së informimit përmes kërkesave për qasje në dokumente publike në gjuhët amtare të komuniteteve jo-shumicë që cilësohen si gjuhë zyrtare në nivel lokal. Pas kërkesave të parashtruara nga Instituti Demokratik i Kosovës, institucionet lokale nuk e kanë respektuar afatin ligjor në kthimin e përgjigjeve. Nga 10 dokumente të ndryshme të kërkuara nga komuna e Prizrenit, prej të cilave shtatë (7) në gjuhën boshnjake dhe tre (3) në gjuhën turke, është pranuar vetëm një dokument në gjuhën serbe.


Sa i përket konsultimeve publike gjatë periudhës Janar - Qershor të vitit 2019 - komuna e Prizrenit në asnjë takim publik konsultativ nuk e ka siguruar përkthimin adekuat në gjuhët tjera zyrtare. Mbetet tejet shqetësuese mungesa e përkthimit të draft dokumenteve në gjuhët tjera zyrtare si dhe mungesa e ftesave në gjuhët tjera zyrtare në organizimin e konsultimeve dhe dëgjimeve publike. Kjo qasje, përjashton mundësinë që qytetarët e komuniteteve jo-shumicë të inkuadrohen në proceset vendimmarrëse.

30 Neni 7 paragrafi 2 i Ligjit Nr. 02/L-37 për përdorimin e gjuhëve, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2440>

31 Po aty neni 8 paragrafi 1

32 Po aty neni 8 paragrafi 4





KOMUNA E DRAGASHIT



Kombësia



Numri



Përqindja

SHQIPTARË	20 287	59,67%
BOSHNJAKË	4 100	12,06%
GORANË	8 957	26,35%

Në komunën e Dragashit, sipas regjistrit të popullsisë 2011 jetojnë 33,362 banorë me një strukturë etnike heterogjene, por që dominohet nga komuniteti shqiptar me 59.67 %. Komuniteti goran është komunitet i dytë në këtë komunë me 26.35% ndërsa ai boshnjak përfshinë 12.06 % të popullsisë së përgjithshme³³. Bazuar në statutin e komunës së Dragashit, gjuhë zyrtare në këtë komunë janë: gjuha shqipe, gjuha serbe dhe gjuha boshnjake.

Ueb faqja zyrtare e Komunës së Dragashit është e ndërtuar në katër versione të gjuhëve: versioni shqip, serbisht/boshnjakisht, turqisht dhe anglisht. Ueb faqja është funksionale vetëm në versionin në gjuhën shqipe, pjesërisht funksionale në versionin në gjuhën serbe, dhe jo funksionale në gjuhën boshnjake.

☰
🖥
✕

UEB FAQJA ZYRTARE E KOMUNËS SË DRAGASHIT ËSHTË E NDËRTUAR NË KATËR VERSIONE TË GJUHËVE:

versioni shqip, serbisht/boshnjakisht, turqisht dhe anglisht. Ueb faqja është funksionale vetëm në versionin në gjuhën shqipe, pjesërisht funksionale në versionin në gjuhën serbe, dhe jo funksionale në gjuhën boshnjake.

33 "Agjencia e Statistikave të Kosovës", <http://askdata.rks-gov.net/PXËeb/pxëeb/sq/askdata/>



Ueb faqja e komunës së Dragashit nuk ka version të veçantë në gjuhën boshnjake edhe pse me ligjet në fuqi dhe statutin e komunës është gjuhë zyrtare në këtë komunë, ku sipas statistikave të regjistrimit të popullsisë, jetojnë rreth 12 % anëtarë të këtij komuniteti jo-shumicë. Në kuadër të ueb faqes, gjuha boshnjake është e përfshirë në linkun e gjuhës serbe.

Komuna e Dragashit ka faqen e saj zyrtare në rrjetin social Facebook të quajtur: "Komuna e Dragashit".³⁴ Të gjitha postimet janë në gjuhën shqipe, pa përkthim në gjuhët e tjera zyrtare të komunës (serbe dhe boshnjake). Në rubrikën e ueb faqes ku janë informatat rreth qytetit si pozita gjeografike, historiku dhe rrugët, përshkrimi është i qasshëm vetëm në gjuhën shqipe, në gjuhën serbe përshkruhet vetëm historiku i komunës.

Në rubrikën "Shpallje" ku përfshihen aplikacionet, konkurset dhe njoftimet, gjatë periudhës Janar - Qershor 2019 janë publikuar 63 shpallje, prej të cilave 12 konkurse, 39 njoftime dhe 12 dokumente në kuadër të rubrikës thirrje për propozime. Prej

63 shpalljeve në gjuhën shqipe, vetëm 18 janë publikuar në gjuhën serbe, përkatësisht 6 konkurse, 11 njoftime, dhe 1 thirrje për propozim. Asnjë nga këto shpallje, nuk është publikuar në gjuhën boshnjake. Kjo qasje e komunës së Dragashit, mohon të drejtën e komunitetit boshnjak për t'u informuar rreth njoftimeve, konkurseve dhe thirrjeve të ndryshme.

Tek rubrika "Prokurimi" komuna publikon njoftimet në gjuhën shqipe dhe gjuhën serbe. Deri në muajin Qershor të vitit 2019 janë publikuar: 108 dokumente në gjuhën shqipe, prej të cilave 106 dokumente në gjuhën serbe dhe 0 dokumente në gjuhën boshnjake. Banorët të cilët flasin gjuhën shqipe dhe ata që flasin gjuhën serbe kanë qasje pothuajse të barabartë në informatat rreth procesit të prokurimit në komunën e Dragashit derisa përjashtohet komuniteti boshnjak në informimin për aktivitetet e prokurimit në këtë komunë.

Në kuadër të rubrikës "Financat" publikohen buxheti, raportet financiare dhe pasqyrat financiare. Gjatë periudhës Janar- Qer-

Shpalljet e publikuara gjatë periudhës Janar-Qershor 2019




Tabela 6. Publikimi i shpalljeve në ueb faqen zyrtare-Dragash

34 Faqja zyrtare e Komunës së Dragashit në rrjetin social Facebook - <https://www.facebook.com/Komuna-e-Dragashit-1228449347299060/>



shor 2019 janë publikuar 7 dokumente, përkatësisht Buxheti 2019, Raporti Janar-Mars 2019, Raporti Vjetor Financiar 2018, Pasqyra Financiare 2018, Raporti i Auditorit për vitin 2018, Korniza Afatmesme Buxhetore 2020-2022 si dhe Investimet Kapitale 2020-2022. Përderisa të gjitha këto dokumente janë të publikuara në gjuhën shqipe, të njëjtat nuk mund të gjenden

në gjuhën serbe dhe boshnjake duke ua cenuar këtyre komuniteteve qasjen në informatat mbi financat e komunës.

Deri në muajin Qershor 2019 komuna e Dragashit ka publikuar 37 lajme. Nga 37 lajme, vetëm 3 lajme janë publikuar në gjuhën serbe, dhe asnjë lajm në gjuhën boshnjake.




Tabela 7. Publikimi i lajmeve në ueb faqen zyrtare - Dragash





Kryetari i Komunës

Kryetari i Komunës sipas përgjegjësisë të tij kujdeset për zbatimin e dispozitave të Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale dhe dispozitat tjera ligjore që kanë të bëjnë me përgjegjësitë e komunave. Kryetar i Komunës së Dragashit në ueb faqe e ka të publikuar biografinë në gjuhët shqipe dhe serbe, pa përkthim në gjuhën boshnjake.

Deri në muajin Qershor 2019 janë publikuar 76 vendime të kryetarit në gjuhën shqipe. Të njëjtat mungojnë në gjuhën serbe dhe boshnjake. Të gjitha vendimet e nënshkruara të muajit Shkurt, Mars, Prill dhe Maj, janë publikuar në muajin qershor 2019.

Raporti i Punës së Kryetarit dhe Drejtorive të Komunës së Dragashit për vitin 2018 dhe Planet e Punës për vitin 2019,

është dokument i publikuar në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe por jo edhe në gjuhën boshnjake. Ajo çka vlen të përmendet për komunën e Dragashit mbetet mungesa e përkthimit në gjuhë tjera zyrtare të Organogramit të komunës së Dragashit, i cili aktualisht është vetëm në gjuhën shqipe.

Shumica e drejtorive nuk i kanë të publikuara fare raportet në asnjë gjuhë zyrtare, megjithatë Drejtoria për Ekonomi dhe Financa ka të publikuar raportet financiare por vetëm në gjuhën shqipe. Në gjuhën shqipe mund të gjenden të publikuara informata rreth shërbimeve, detyrave dhe përgjegjësisë të secilës zyrë / njësi dhe secilit sektor të komunës së Dragashit, këto informata nuk janë të përkthyer në gjuhën serbe dhe boshnjake. Sfiduese për këtë komunë mbetet mungesa e gaditshmërisë për të përkthyer dhe lejuar qasje në informacione komunitetit jo-shumicë boshnjak.



Tabela 8. Vendimet e publikuara të Kryetarit të Komunës në periudhën Janar-Qershor 2019





Kuvendi i Komunës

Kuvendi i Komunës së Dragashit gjatë periudhës Janar - Qershor 2019 ka publikuar 11 vendime, nga këto: 11 vendime në gjuhën shqipe, 10 vendime në gjuhën serbe dhe zero (0) vendime në gjuhën boshnjake.

Në ueb faqe gjejmë të publikuar Rregulloren për Tatim në Pronë 2019 dhe Rregulloren për Caktimin e Orarit të Punës të Subjekteve Afariste të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Dragashit. Të dy këto rregullore janë të publikuara në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe por jo edhe në gjuhën boshnjake.

Raporti i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi 2018, dhe Plani i Veprimit i KKSBB 2019, biografitë e anëtarëve të Kuvendit të Komunës, nuk janë të publikuara fare në ueb faqe të Komunës.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Kuvendit të Komunës, Statuti i komunës janë të qasshme vetëm në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe, por jo edhe në gjuhën boshnjake. Në rubrikën "Kuvendi" në kuadër të ueb faqes zyrtare publikohen thirrjet për seanca të Kuvendit Komunal dhe procesverbalet e dalura nga ato seanca. Thirrjet dhe procesverbalet publikohen në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe, mungojnë në gjuhën boshnjake. Në ueb faqe nuk ka asnjë ftesë të publikuar për mbledhjet e Komitetit për Komunitete.



Tabela 9. Vendimet e Kuvendit të Komunës të publikuara gjatë periudhës Janar-Maj 2019.



REKOMANDIMET



Komuna e Prizrenit

- Të shtohet seksioni i gjuhës boshnjake në ueb faqen e komunës dhe të funksionalizohet në tërësi seksioni në gjuhën turke.
- Qeveria lokale duhet t'i publikojë njoftimet, raportet, vendimet dhe gjithë dokumentacionin publik në gjuhët zyrtare të komunës
- Faqja zyrtare në rrjetin social "Facebook" të ketë publikime edhe në gjuhët tjera zyrtare.
- Të rriten kapacitetet institucionale që të mundësojnë përkthimin e draft dokumenteve dhe dokumenteve zyrtare.
- Të respektohen afatet ligjore për përgjigje në kërkesat për qasje në dokumente zyrtare dhe të komunikohet me palën në gjuhën të cilën ajo e kërkon.
- Të sigurohet përkthim adekuat për komunitetet joshumicë në takimet dhe konsultimet publike si dhe gjatë mbledhjeve të Kuvendit Komunal.



Komuna e Dragashit

- Të shtohet seksioni i gjuhës boshnjake në ueb faqen e komunës.
- Qeveria lokale duhet t'i publikojë njoftimet, raportet, vendimet dhe gjithë dokumentacionin publik në gjuhët zyrtare të komunës.
- Faqja zyrtare në rrjetin social "Facebook" të ketë publikime edhe në gjuhë tjera zyrtare.
- Të rriten kapacitetet institucionale që të mundësojnë përkthimin e draft dokumenteve dhe dokumenteve zyrtare.
- Të respektohen afatet ligjore për përgjigje në kërkesat për qasje në dokumentet zyrtare dhe të komunikohet me palën në gjuhën të cilën ajo e kërkon.

Zyra e Komisionerit

- Zyra e Komisionerit të bëjë presion mbi institucionet lokale në respektimin e gjuhëve zyrtare në nivel lokal dhe të filloj shqiptimin e sanksioneve administrative.

LISTA E BURIMEVE TË SHFRYTËZUARA

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, <http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Kushtetuta.e.Republikes.se.Kosoves.pdf>

Ligji Nr. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>

Ligji Nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2440>

Ligji Nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2531>

Udhëzimi Administrativ Nr.2007/01 për përcaktimin e sanksioneve administrative për shkeljen e Ligjit për Përdorim të Gjuhëve, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7473&fbclid=IwAR2zWjEP0AGyumPzS6s6B2Ng17nyBYt6d-FmXAXAvf2SBC6LE7WTJpknZyha>

Rregullore Nr. 07/2012 për Zyrën e Komisionerit për Gjuhët, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8364>

Statuti i Komunës së Prizrenit, [https://kk-arkiva.rks-gov.net/prizren/Kuvendi-\(1\)/Statut.aspx](https://kk-arkiva.rks-gov.net/prizren/Kuvendi-(1)/Statut.aspx)

Statuti i Komunës së Dragashit, <https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2018/01/statuti-i-komunes-dragash.pdf>

Rregullore për përdorimin e gjuhëve – Komuna e Prizrenit, [https://kk-arkiva.rks-gov.net/prizren/getattachment/Kuvendi-\(1\)/Regulations/RregullorePerdoriminGjuheve.pdf.aspx?fbclid=IwAR2cD-mY9aFb62JBKyhOuMwjKPI817dKcYL_goc-GQUS7Sefx6DMvzR_ajl](https://kk-arkiva.rks-gov.net/prizren/getattachment/Kuvendi-(1)/Regulations/RregullorePerdoriminGjuheve.pdf.aspx?fbclid=IwAR2cD-mY9aFb62JBKyhOuMwjKPI817dKcYL_goc-GQUS7Sefx6DMvzR_ajl)

Rregullore për përdorimin e gjuhëve, Komuna e Dragashit, https://kk-arkiva.rks-gov.net/dragash/getattachment/97ea4ed-b-7051-4b2c-a81c-8364174fe30e/Rregullorja-pe-perdorimin-e-gjuheve-2009.aspx?fbclid=IwAR3rkvLx0Q81A-UPT-tT7e-Hwp1kSi10MCloilu0c1i1XDdYp0kQj7Tx1_AU

Agjencia e Statistikave të Kosovës, <http://askdata.rks-gov.net/PXËeb/pxweb/sq/askdata/>

Ueb faqja e Komunës së Prizrenit, <https://kk.rks-gov.net/prizren/>

Ueb faqja e Komunës së Dragashit, <https://kk.rks-gov.net/dragash/>

KDI është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes së qytetarëve në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike.

Për më shumë informata rreth KDI ju lutem vizitoni www.kdi-kosova.org



This publication is part of the project **Civic Involvement for Transparency and Accountability**, implemented by **Kosova Democratic Institute**, financed by Olof Palme International Center supported by Sëedish Government. Content of this publication reflects author's opinions and not necessarily Olof Palme International Center opinions.